

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7144  
E hënë, 18 mars 2024  
Çmimi 0.50

Analistët: Deklaratat e Escobarit nuk lënë hapësirë për interpretime | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPOZITA KËMBËNGUL PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME



Kërkesën për zgjedhje të reja në vend partitë opozitare po e shfaqin çdo ditë e më shumë. Zyrtarët e PDK-së dhe të LDK-së thonë se vendi duhet sa më shpejt të shkojë në zgjedhje të parakohshme

parlamentare. "Sa më shpejt që është e mundur ne duhet të shkojmë në zgjedhje dhe sovranitë të vendosë kush do ta udhëheqë Kosovën në vitet e ardhshme", ka thënë deputeti i PDK-së, Rashit

Qalaj. Ndërsa deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se çdo ditë qëndrimi i kësaj qeverisje është dëmi i madh për vendin. Prandaj, edhe kjo këmbëngul për zgjedhje sa më parë

### AKTUALE



**KËSHILLI I AMBASADORËVE AMERIKANË: SHTETET E BASHKUARA DUHET TË MBESIN TË ANGAZHUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR** F. 2

**KURTI SHKOI PËR NGUSHËLLIME NË FAMILJEN E GAZETARIT E SHKRIMTARIT TË NJOHUR BAJRAM SEFAJ** F. 6

**SHQIPËRIA MIRËPRET PROJEKTET TURISTIKE TË PROPOZUARA NGA KOMPANIA E JARED KUSHNERIT** F. 3

### EKONOMI



**KRYETARI I OEK-ut: BIZNESET PO MARRIN PUNËTORË NGA BANGLADESHI DHE INDIA** F. 7

**KOSOVA, E FUNDIT NË RAJON PËR PAGËN MESATARE** F. 7

### SPORT



**DY DERBIT PËRFUNDOJNË PA FITUES**

F. 10

**APLIKIMI I KOSOVËS NË KIE, MË 27 MARS MBLIDHET KOMISIONI PËR POLITIKË DHE DEMOKRACI** F. 3



**BORRELLI: KOHA QË KOSOVA DHE SËRBIJA TË FUTEN NË NJË EPOKË TË RE DUKE ZBATUAR MARRËVESHJEN E OHRIT** F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
**STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË**

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Netanyahu: Aleatët tanë kanë kujtesë të dobët për sulmin e 7 tetorit

**JERUSALEM, 17 MARS** - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha të dielën se aleatët e Izraelit kanë kujtesë të dobët në lidhje me sulmin e 7 tetorit që e kreu Hamas - grupi i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Ai u zotua se forcat izraelite do ta vazhdojnë ofensivën ushtarake në Rripin e Gazës me gjithë tryshninë e madhe ndërkombëtare. "Miqve tanë në bashkësinë ndërkombëtare u them: A është kujtesa juaj aq e dobët? Ju e harruat kaq shpejt 7 tetorin, masakrën më të rëndë kundër hebrenjve prej Holokaustit", tha Netanyahu. "A jeni të gatshëm t'ia mohoni kaq shpejt Izraelit të drejtën për t'u mbrojtur kundër përbindësive si Hamas?" shtoi ai.

Netanyahu përsëriti se Izraeli do të kryejë ofensivë edhe në Rafah.

Presidenti amerikan Joe Biden i ka rritur kritikën ndaj Netanyahu. Ai tha kohë më parë se Netanyahu "më shumë po e lëndon sesa po e

ndihmon Izraelin" me mënyrën se si ai po i qaset luftës kundër Hamasit.

Bideni tha se mbështet të drejtën e Izraelit për t'iu kundërpërgjigjur Hamasit pas sulmit të 7 tetorit në jug të Izraelit, por tha se Netanyahu "duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi jetës së të pafajshmëve që po humbet për shkak të veprimeve që po ndërmerren".

Zyrtarët egjiptianë thanë të shtunën se bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje armëpushimi në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit pritet të nisnin të dielën ose të hënën.

Hamas kërkon armëpushim të përhershëm në Gazë, gjë që është kundërshtuar nga Qeveria e Netanyahut, e cila ngul këmbë se, së pari, duhet ta përmbushë synimin për ta "çrënjësuar Hamasin".

Zyrtarët e grupeve humanitare kanë paralajmëruar se Gaza po shkon drejt urisë absolute.



Lufta vdekjeprurëse e Izraelit në enklavën palestineze nisi pasi pjesëtarët e Hamasit u futën vullshëm në jug të Izraelit më 7 tetor 2023, duke i vrarë 1 200

njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i rrëmbyer 250 pengje.

Më shumë se 31 000 palestinezë janë vrarë në Rripin e Gazës prej atëherë, sipas autoriteteve

shëndetësore palestineze, nga ofensiva ajrore, detare dhe tokësore e Izraelit, e cila ka shkaktuar rrënim të madh në enklavë.

## Lava e vullkanit rrjedh drejt qytetit islandez pas shpërthimit të ri vullkanik

**Grindavik, 17 mars** - Autoritetet islandeze kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme të dielën në veri të Islandës pas një shpërthimi të ri vullkanik në Gadishullin e Reikjanes.

Ky ishte shpërthimi i katërt vullkanik në këtë gadishull prej dhjetorit të kaluar.

Besohet se ky është shpërthimi më i fuqishëm deri tani. Lava e zjarrtë ka rrjedhur deri te muret mbrojtëse përreth qytetit të evakuuar, Grindavik, njoftuan autoritetet.

Njerëzit janë larguar edhe nga Blue Lagoonspa, një prej atraksioneve më të mëdha turistike të Islandës.



Hapësira ajrore e Islandës mbetet e hapur.

Sipas autoriteteve, shpërthimi i vullkanit nisi në orën 20:00 të shtunën në veri të Grindavikut, në lokacionin ku kishte nisur shpërthimi edhe më 8 dhjetor.

Qyteti me 3 800 banorë afër aeroportit kryesor të Islandës u evakuua më 10 nëntor kur një sërë tërmetesh shkaktuan çarje të tokës mes Grindavikut dhe Sýlingarfellit, një qytet i vogël bjeshkor në veri.

Disa banorë që ishin kthyer në Grindavik u detyruan të evakuoohen përsëri të shtunën.

Vullkani filloi të shpërthejë përfundimisht më 18 dhjetor, duke lëshuar lavë në drejtim të

Grindavikut. Një shpërthim i dytë ndodhi më 14 janar dhe lava e tij rrodhi drejt qytetit.

Muret mbrojtëse të cilat ishin forcuar pas shpërthimit të parë e ndalën një pjesë të lavës, por disa ndërtesa u gllabëruan nga lava.

Dy shpërthimet e para zgjatën pak ditë. Shpërthimi i tretë ndodhi më 8 shkurt dhe zgjati pak orë.

Në Islandë ndodh shpërthimi i një vullkani çdo katër-pesë vjet mesatarisht. Më 2010 ndodhi shpërthimi i vullkanit Eyjafjallajökull, më i madhi në vitet e fundit, duke lëshuar re të mëdha hiri në atmosferë, gjë që shkaktoi mbylljen e hapësirave ajrore nëpër Evropë.

## Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë: Shtetet e Bashkuara duhet të mbesin të angazhuara në Ballkanin Perëndimor

**Uashington, 17 mars** - Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë ka botuar këto ditë një raport pas vizitës fakt-mbledhëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", ambasadori Philip Hughes, përfaqësuesi i këtij grupi që mbledh rreth vetes ambasadorë jo të karrierës, thotë se këto tre shtete të Ballkanit kanë bërë përparim të jashtëzakonshëm, por ato vazhdojnë të përballen me sfida nga ndërhyrjet politike të fqinjëve të tyre apo në rastin e Shqipërisë nga kriminaliteti dhe korrupsioni dhe mungesa e një demokracie të

mirëfilltë. Hughes, po ashtu, foli për vendimin e Shteteve të Bashkuara për ta shpallur person non-grata ish-presidentin e Shqipërisë, Sali Berisha.

Ai mendon se angazhimi për Ballkanin mbetet i një rëndësie shumë të rëndësishme. "Sepse është një rajon që po bën përparim demokratik dhe ekonomik. Shpresoj që edhe Kosova një ditë të kalojë pragun dhe të anëtarësohet jo vetëm në BE, por në NATO për ta plotësuar praninë e aleancës në këtë pjesë të botës. Por nga përvoja ime, Shteteve të Bashkuara shpesh u duhet të përballen me çështje

urgjente, dhe kjo shkakton vonesa në trajtimin e çështjeve të tjera të rëndësishme. Gjatë viteve '90 konfliktet në Ballkan ishin kriza të menjëhershme. Tani ato nuk janë të tilla, por mund të bëhen sërish pjesë e një krize të menjëhershme, nëse konflikti në Ukrainë ka një përfundim të keq për ukrainasit, ose nëse Rusia vazhdon agresionin, apo në rastin ekstrem, synon të vërë në provë Nenin 5 të traktatit të NATO-s, në përpjekje për ta thyer aleancën. Prandaj ky rajon duhet të ketë vëmendje politike të vazhdueshme dhe përparësi nga Shtetet e Bashkuara", ka thënë Hughes.





## Borrelli: Koha që Kosova dhe Serbia të futen në një epokë të re duke zbatuar marrëveshjen e Ohrit

**PRISHTINË, 17 MARS** - Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë të dielën se tani është koha që Kosova dhe Serbia t'i japin fund krizës dhe tensioneve dhe të ecin përpara në një "epokë të re evropiane" duke zbatuar marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore.

Borrelli tha më 17 mars, një ditë para njëvjetorit të arritjes së Marrëveshjes së Ohrit në mes të Kosovës dhe Serbisë, se "është për të ardhur keq që, përkundër përpjekjeve gjithëpërfshirëse nga BE-ja dhe nga bashkësia ndërkombëtare, deri tani Kosova dhe Serbia kanë shënuar përparim shumë të kufizuar në zbatimin e obligimeve që i pranuan sipas kësaj marrëveshjeje".

Më 27 shkurt 2023 në Bruksel, Kosova dhe Serbia kishin arritur Marrëveshjen Bazë, ndërkaq më 18 mars në Ohër u arrit pajtimi për Aneksionin e zbatimit të marrëveshjes.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Brukseli i ka akuzuar të dyja palët për moszbatim të marrëveshjes.

Shefi i diplomacisë evropiane tha se pret nga liderët e Kosovës dhe të Serbisë të tregojnë "përgjegjësi, vizion dhe lidhshmëri duke shënuar përparim në zbatimin e marrëveshjes pa vonesa".

Zyrtarë të lartë të Kosovës dhe të Serbisë kanë shprehur vazhdimisht qëndrime që lënë të kuptohet se nuk janë të gatshëm t'i përmbahen marrëveshjes.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, këmbëngul në nënshkrimin e marrëveshjes, pasi, siç konsideron ai, kjo do të ishte garanci që edhe Serbia do t'i përmbushte obligimet e saj.

Në mes të janarit të këtij viti, ai tha, po ashtu, se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe "nuk është prioritet" për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe se nuk duhet veçuar.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, tha më herët se nuk do të nënshkruajë asnjë marrëveshje që do ta nënkuptonte njohjen e Kosovës apo anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara.

Më 14 dhjetor kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, dorëzoi një letër zyrtare në selinë e Bashkimit Evropian, duke shprehur rezervë për detyrimet që dalin nga marrëveshja dhe aneksi për zbatimin e saj.

Borrelli tha se në kohë të "luftërave



të papara në kontinentin tonë", arritja e një marrëveshjeje që premtonte paqe, stabilitet dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore "ishite arritje historike".

Ai i paralajmëroi Kosovën dhe Serbinë se e ardhmja e tyre evropiane varet nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe se ajo është detyrim për to në përputhje me ligjin ndërkombëtar. "Mungesa e zbatimit jo vetëm që ua rrezikon palëve integrimin evropian, por edhe ua dëmton reputacionin si partnerë të besueshëm", tha ai.

Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur prej 1 shkurtit, kur nisi të zbatohet një rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës që parasheh euron si valutën e vetme për kryerjen e pagesave me para të gatshme, duke ndaluar dinarin serb.

Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

BE-ja ka njoftuar se më 19 mars në Bruksel, në nivel të

kryenegociatorëve, Kosova dhe Serbia do të diskutojnë për çështjen e dinarit.

Blloku evropian, por edhe Shtetet e Bashkuara, kanë kritikuar vendimin për dinarin, duke thënë se ai është marrë pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimet negative që ka te komuniteti serb.

Uashingtoni i ka kërkuar Kosovës ta shtyjë ose ta pezullojë vendimin, por deri më tani Qeveria e Kosovës nuk ka shfaqur sinjale se do të tërhiqet nga kjo rregullore.

## Shqipëria mirëpret projektet turistike të propozuara nga kompania e Jared Kushnerit

**TIRANË, 17 MARS** - Në Tiranë kryeministri Edi Rama mirëpriti të dielën planet e kompanisë amerikane "Affinity Partners" të sipërmarrësit Jared Kushner për të investuar në turizmin shqiptar.

Kushner, dhëndri i ish-presidentit Donald Trump, publikoi në rrjetin X pamje nga projektet që ai synon të realizojë në ishullin e Sazanit dhe në zonën e Zvërnecit. Por për këtë të fundit, ministria shqiptare e Turizmit deklaroi se nuk ka ende dijeni.

Ndërsa i bëri jehonë zhvillimit të sektorit të turizmit në vend, veçanërisht pas ecurisë gjatë vitit të shkuar, duke folur në Asambleen e Partisë Socialiste e cila u mbajt sot në një nga zonat e bregdetit të Durrësit, kryeministri Edi Rama foli edhe për planet e shpallura publikisht nga sipërmarrësi amerikan Jared Kushner. "Këto ditë Jared Kushner, një sipërmarrës i madh amerikan dhe dhëndri i ish-presidentit Trump, shpalli publikisht ambicien për të investuar në dy projekte të mëdha turistike në Shqipëri. Po ata që na tregonin Malin e Zi për zhvillimin e turizmit dhe investimet e huaja direkte, sot na flasin për rrezikun që i kanoset Sazanit nga kthimi në një xhevahir i kurorës së artë të turizmit në Mesdhe", tha Rama.

Edhe pse përmendi dy projekte, kryeministri u ndal vetëm te plani



për ishullin e Sazanit.

Dy ditë më parë, në një intervistë për "Bloomberg News", dhëndri i ish-presidentit Donald Trump bëri me dije se po planifikon ta shndërrojë ishullin e Sazanit në një eko-resort luksoz.

Ai shtoi se kompania e tij "Affinity" kërkon ta zhvillojë zonën e Zvërnecit, pranë Vlorës, duke planifikuar ndërtimin e disa resorteve me afro 10 mijë dhoma hotelesh dhe vila. Kushner

publikoi në rrjetin social X disa pamje ilustruese të të dy projekteve për të investuar në bregdetin e Shqipërisë.

Në komentet për "Zërin e Amerikës", Ministria e Turizmit dhe Mjedisit konfirmoi aplikimin e kompanisë së Kushnerit për projektin në ishullin e Sazanit, por tha se nuk ka dijeni mbi një projekt për Zvërnecin.

Njoftimi i Kushnerit përkon me ndryshimet që shumica socialiste

miratoi pak javë më parë mbi një variant të qeverisë për "Zonat e Mbrojtura", të cilat i hapin rrugë ndërtimit në to, të hoteleve apo projekteve të tjera që konsiderohen si investime strategjike.

Rama foli me ironi ndaj atyre që shohin një lidhje direkte mes këtyre ndryshimeve dhe projekteve të shpallura nga Kushner, i cili vitin e kaluar kishte vizituar Shqipërinë, në shoqërinë

e ish-ambasadorit amerikan në Gjermani, Richard Grenell.

Ekspertë të mjedisit vërejnë se trualli i ishullit të Sazanit është zonë ushtarake, por nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura natyrore, ndërsa perimetri ujqor rreth ishullit është pjesë e Parkut Kombëtar Detar Sazan - Karaburun.

Ndërsa Zvërneci, theksojnë ata, është zonë e mbrojtur e kategorisë 5, pjesë e peizazhit të mbrojtur Vjosë - Nartë, dhe aty nuk lejohet ndërtimi, sepse është pjesë e zonës qendrore.

Në ndryshimet e fundit ligjore, sipas tyre, qeveria ka hequr nënzonimet nga peizazhet e mbrojtura, duke ua hapur rrugën ndërtimit në zonat e mbrojtura, ndërsa me ligjin e mëparshëm nuk lejohet ndërtimi në asnjë zonë të mbrojtur.

Këto ndryshime ligjore janë kundërshtuar me forcë nga organizatat mjedisore, nga opozita, që i shohin këto si ligje me porosi. Për ndryshimet e fundit në këtë ligj pritet qëndrimi i presidentit të Republikës, nëse do t'i miratojë ato, apo nëse do t'i kthejë për rishikim në Kuvend. Baza e Limionit u vu nën sekuestro preventive një vit më parë, duke ndërprerë investimet në zonë pasi, sipas Prokurorisë, "disponimi i kësaj prone nga subjektet private cenon gatishmërinë dhe operacionalitetin e Forcës Detare".





# Opozita këmbëngul për zgjedhje të parakohshme

Kërkesën për zgjedhje të reja në vend partitë opozitare po e shfaqin çdo ditë e më shumë. Zyrtarët e PDK-së dhe të LDK-së thonë se vendi duhet sa më shpejt të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. “Sa më shpejt që është e mundur ne duhet të shkojmë në zgjedhje dhe sovrani të vendosë kush do ta udhëheqë Kosovën në vitet e ardhshme”, ka thënë deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj. Deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se çdo ditë qëndrimi i kësaj qeverisje është dëmi i madh për vendin. Prandaj, ajo këmbëngul për zgjedhje sa më parë

**PRISHTINË, 17 MARS** - Kërkesën për zgjedhje të reja në vend partitë opozitare po e shfaqin çdo ditë e më shumë. PDK-ja dhe LDK-ja këmbëngulin që vendi sa më shpejt duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Ndonëse kanë mbetur edhe pak muaj deri në përfundim të mandatit të qeverisë Kurti, partitë opozitare shohin vetëm zhgënjim dhe mospërbushje të

premtimeve. Prandaj, zgjedhjet i shohin zgjidhje. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rashit Qalaj, thotë për “Ekonomia Online” se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. “Mendoj se zgjedhjet e reja janë procesi më i domosdoshëm për këtë vend duke parë gjithmonë këtë qeverisje, mënyrën e keqe të qeverisjes së këtij vendi dhe një situatë mjaft të rëndë, qoftë

ekonomike, qoftë në aspekte të tjera të këtij vendi. Prandaj, mendoj që sa më shpejt që është e mundur duhet të shkojmë në zgjedhje dhe sovrani të vendosë kush do ta udhëheqë Kosovën në vitet e ardhshme”, thotë Qalaj. Përveç PDK-së, zgjedhje të reja po kërkon edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Deputetja e kësaj partie, Valentina Bunjaku-Rexhepi, thotë se çdo ditë qëndrimi i kësaj qeverisje është dëmi i madh për vendin. Prandaj, ajo këmbëngul për zgjedhje. “Edhe një ditë nëse vazhdon kjo qeveri është edhe dhjetëfish dëmi më i madh për qytetarët e Republikës së Kosovës. Normalisht që duhet shkruar në zgjedhje, por ne si opozitë e kemi të pamundur ta dërgojmë Kosovën në zgjedhje, sepse kemi pak numra në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë që një parti politike të votohet me kaq besim të madh, mbi 50 për qind

të deputetëve dhe me pas shumicën parlamentare, e pa asnjë koalicion tjetër sikurse që i ka ndodhur LV-së. Edhe pse ka pasur numra mjaftueshëm në parlament, është dashur ta dërgojë agjendën e Kuvendit. Kjo është një qeveri, një mazhorancë që më së paku ka punuar për të mirën e qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Ajo ka shtuar se sa iu përket zgjedhjeve të reja, atë minutë që Kurti është i gatshëm të shkojë në zgjedhje, Lidhja Demokratike e Kosovës është e gatshme. “I ka dalë fytyra e vërtetë dhe kauzat e rrejshme të Kurtit tanimë i kanë kuptuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. I falënderoj të gjithë qytetarët që i kanë thirrur mendjes dhe e kanë ndryshuar bindjen karshi qeverisë krejt dhe drejt, krejt dhe rrenë”, u shpreh ajo. Mendim të ngjashëm për të shkuar në zgjedhje nuk ka edhe

ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi. Ai thotë se qeveria Kurti duhet ta përfundojë mandatin. Madje Abazi nuk i sheh aq serioze deklarimet e opozitës për të shkuar në zgjedhje të parakohshme. “Nuk shoh ndonjë arsye, sepse mendoj se Kurti duhet ta përfundojë mandatin e vet ashtu siç i është dhënë. Nuk ka të interesuar nga opozita në formën serioze për ta rrëzuar këtë qeveri. Duhet t'i lihet mundësia për të parë së fakti për katër vjet ka arritur të bëjë minimalisht, mos të themi asgjë për të mirën e Kosovës, sepse ky mit i krijuar dhe premtimet që janë dhënë, realisht janë përkthyer në asgjë tjetër përveçse një pushtet autokratik dhe populizëm dhe luftë propagandistike ndaj kundërshtarëve politikë. Asgjë konkrete në kuptimin e përmirësimit të jetës dhe realizimit të premtimeve të dhëna në fushatat elektorale”, u shpreh Abazi.



## Aplikimi i Kosovës në KiE, më 27 mars mbledhet Komisioni për Politikë dhe Demokraci

PRISHTINË, 17 MARS - Më 27 mars në Asamblenë e Përgjithshme të Këshillit të Evropës do të paraqitet raporti për Kosovën që përmban një draft-opinion. Lidhur me këtë ngjarje të rëndësishme për Kosovën, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka njoftuar se është duke udhëtuar për në Paris. "Jam rrugës për Paris, ku si anëtar në Komitetin për Barazi dhe Jo-Diskriminim në kuadër të Këshillit të Evropës do të diskutojmë çështje tematike të Komitetit, por edhe do të kam takime rreth anëtarësimit të Kosovës në Këshill. Dy momente janë me rëndësi në

këto javë. Takimi që do të mbahet më 27 mars 2024 i Komisionit për Politikë dhe Demokraci. Ky takim është i jashtëzakonshëm me pikën e vetme: aplikimin e Kosovës. Raporti duhet të votohet me 1/2, pra 27 deputetë duhet të votojnë në Komitet dhe të dërgohet në seancën plenare në PACE për votim. Në Asamblenë Parlamentare kërkohen 2/3 e votave", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vujiç, tha se në ditët në vijim e presin lajme të këqija Serbinë, e kjo ka të bëjë lidhur me anëtarësimin e Kosovës në

Këshillin e Evropës. "Do t'ju shpjegoj se si na mashtruan disa të ashtuquajtur miq dhe na gënjyen në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës. U thamë se çfarë do të ndodhë nëse kjo ndodh, sepse ata mendojnë se kanë të drejtë ta zbatojnë marrëveshjen në mënyrë mashtruese. Do të jetë shumë e vështirë për ne, sepse qëllimi i dikujt është që ta shtyjë popullin serb sa më larg Kosovës dhe t'u sigurojë legjitimitet e ligjshmëri të plotë veprimeve të atyre që i dëbojnë serbët. Është vetëm një pjesë e asaj që na pret", ka deklaruar të dielën Vujiçi.



## Analistët: Deklaratat e Escobarit nuk lënë hapësirë për interpretime



PRISHTINË, 17 MARS - Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është një kërkesë tjetër e ndërkombëtarëve karshi autoriteteve të Kosovës. Megjithatë njohësit e çështjeve politike në vend po konsiderojnë se kjo temë mund të zgjidhet njëllor si ajo e Manastirit të Deçanit derisa deklaratat e emisarit amerikan, Escobar, po i quajnë të prera. "Deklaratat e Escobarit ishin

shumë të qarta, por shumë kritike dhe nuk lënë hapësirë për interpretime. Pra, kërkesa e tij që të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese drafti i Asociacionit është një urgjencë dhe sa më shpejt që e dërgon kryeministri Kurti këtë statut në Gjykatën Kushtetuese aq më mirë do të jetë për të, në të kundërtën presionet vetëm sa do të rriten derisa të bëhen të padurueshme dhe pastaj do të kemi probleme të

jashtëzakonshme", ka thënë për RTK-në, Artan Muhaxhiri, analist politik.

Edhe analistja politike Arta Tahiri Beqa po konsideron se pas Marrëveshjes së Deçanit, e cila ishte në përputhje me Kushtetutën e vendit, qeveria do të vazhdojë t'i zbatojë marrëveshjet që nuk janë në kundërshtim me të.

Tahiri vlerëson se me këtë rast Kosova duhet të përfitojë më shumë. "Çka do të fitojë Kosova

në këtë mes, në këtë dialog? Në këtë bisedim çka do marrë Kosova? Me çështjen e vendimit për Manastirin e Deçanit Kosova nuk mori asgjë konkrete, vetëm se mendohet se mund të jetë pjesë apo të hapet drita e gjelbër për Këshillin e Evropës, e që mendoj se është shumë pak. Ajo çfarë duhet të fitojë Kosova në këtë rast, sidomos me krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe,

duhet patjetër të jetë njohja në qendër nga ana e Serbisë dhe të jetë e domosdoshme që Kosovës t'i hapet e drejta për të qenë anëtare e Bashkimit Evropian", ka thënë Tahiri-Beqa.

Analistët po konsiderojnë se marrëveshjet që janë verifikuar nga Gjykata Kushtetuese do të duhej të jetësoheshin shumë më herët që Kosova të mos humbte kohë drejt integritetit të saj.

## Avokatja Nina Tavakoli i bashkohet ekipit mbrojtës të Thaçit

PRISHTINË, 17 MARS - Avokatja Nina Tavakoli i është bashkuar ekipit mbrojtës të Hashim Thaçit. Kështu ka bërë me dije Gjykata Speciale përmes një njoftimi. "Në bazë të rregullit 26(1) të Rregullores 1, Sekretari njofton Trupin Gjykses të miratimit të znj. Nina Tavakoli si bashkavokate për

Hashim Thaçin dhe në përputhje me rregullën 26(1) të Rregullores dhe nenin 18(6) të Direktivës për avokatin, 2 e informon Trupin Gjykses për përfundimin e emërimit të Albert Moskowitz si bashkavokat i Thaçit", thuhet në njoftim.

Më tutje, bëhet me dije se më

4 mars të këtij viti avokati Misetiq e ka informuar sekretarin se do të dëshironte të ndihmohej nga Tavakoli si bashkavokate.

"Tavakoli është pranuar në listën e avokatëve në përputhje me nenin 7(3) dhe 18(1) të Direktivës për avokatin", thuhet tutje në njoftim.





## Kurti shkon për ngushëllime në familjen e gazetarit e shkrimtarit të njohur Bajram Sefaj

PRISHTINË, 17 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të dielën ka shkuar për ngushëllime në familjen e gazetarit dhe shkrimtarit të njohur Bajram Sefaj, i cili u

nda nga jeta të martën e 12 marsit. Duke shprehur ngushëllimet e tij, kryeministri Kurti tha se Sefaj do të kujtohet përherë për punën e tij fisnike si gazetar

dhe për krijimtarinë e tij të pasur letrare dhe publicistike. “Një jetë e plotë që ia ka vlejtur fort. Për vetën e tij dhe për neve që e njohëm, i lexuam e do t’i lexojmë

përsiatjet dhe përvojat e tij të kthyer në libra për të tjerët. Me mall e nderime për Bajram Sefajn”, ka shkruar kryeministri Kurti në librin e ngushëllimeve.



## Kamionët e mallrave nuk respektojnë orarin e qarkullimit në Prishtinë, por as nuk gjobiten

PRISHTINË, 17 MARS - Furnitorët dhe kamionët që bartin material ndërtimor në kryeqytet po vazhdojnë të mos respektojnë rregulloren e cila parashihet lëvizjen e tyre, duke krijuar kështu kolona nëpër rrugë, si dhe bllokim të trotuarëve për këmbësorët. Komuna e Prishtinës në fund të vitit 2022 mori vendim që mjetet motorike dhe elektronike që kanë qëllim furnizimin me mallra të subjekteve afariste të lejohen në sheshin e kryeqytetit nga ora 23:00 deri në orën 07:00, por jo më shumë se 3.5 tonë. Kurse nga ora 19:00 e deri në orën 07:00 lejohet qarkullimi në rrugët “Bill Clinton”, “Idriz

Gjilani”, “Bekim Fehmiu”, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, pastaj nga rrethrotullimi i Flamurit, rruga “Agim Ramadani” dhe udhëkryqi të konviktet, rruga “Edmond Hoxha”, te salla 1 Tetori, rruga “Ilir Konushevi”, në hyrje të qytetit nga drejtimi i Podujevës, si dhe te hyrja në qendër të qytetit nga rrethrotullimi në lagjen Arbëria, në rrugën e “UÇK-së” dhe rrugën “Fehmi Agani”. Ndërsa nga ora 18:00 e deri në orën 07:00 lejohet qarkullimi në zonën periferike të kryeqytetit, pjesë kjo e quajtur si Zona 2. Por në Prishtinë po ndodh krejt e kundërta, pasi furnitorët nuk po e respektojnë këtë rregullore



dhe po vazhdojnë të qarkullojnë gjatë ditës. Qarkullimi i tyre në

kohë të pacaktuar po ngufat rrugët e kryeqytetit dhe po

bllokun automjetet e vogla, duke vështirësuar kështu edhe lëvizjen e këmbësorëve.

Disa nga qytetarët të cilët i ka intervistuar “KosovaPress” janë ankuar se kamionët po i pengojnë gjatë ditës. Një qytetar nga Prishtina tha se furnitorët dhe kamionët të cilët kryejnë punë të vrazhda duhet të qarkullojnë gjatë natës sikurse funksionojnë edhe në Evropë. Ai tha se kamionët parkohen në mes të rrugës dhe kjo nuk është e lejueshme. Ndërkaq, një qytetar tjetër tha se çështja e lëvizjes së kamionëve të mallrave në Prishtinë, duhet të rregullohet me ligj sepse qarkullimi i tyre po i bllokun rrugët.

## PDK-ja mban kuvende zgjedhore në Belgjikë, synon shtrirjen dhe organizimin kudo që jetojnë mërgimtarët



PRISHTINË, 17 MARS - Partia Demokratike e Kosovës ka njoftuar se ka mbajtur këtë fundjavë dy kuvende zgjedhore në Bruksel dhe Namur të Belgjikës për ta vazhduar shtrirjen dhe organizimin kudo që jetojnë mërgimtarët. Nga Kryesia Qendrore u tha se të pranishëm në këto kuvende zgjedhore ishin Zenun Pajaziti dhe Betim Gjoshi. Po në këto kuvende zgjedhore morën pjesë edhe anëtarë të Këshillit për Organizimin e Kuvendit të Degës së PDK-së për Belgjikë

në krye me kryetarin e këshillit, Jetlir Llugani. Sekretari i PDK-së për Organizim dhe Zgjedhje, Betim Gjoshi, tha se rikthimi në secilin qytet ku jetojnë shqiptarët në mërgatë është një hap i rëndësishëm drejt forcimit dhe organizimit të Partisë Demokratike të Kosovës e cila ka dëshmuar se është në shërbim të secilit qytetar kudo që jeton. Anëtarët e Kuvendit Zgjedhor në Bruksel kanë zgjedhur kryetar Fatmir Rredhakun, ndërsa në qytetin e Namurit kryetar Kujtim Bacajn.

## Haradinaj në Zvicër takohet me mërgimtarë: Bashkë drejt fitoreve për Kosovën

Prishtinë, 17 mars - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka takuar bashkatdhetarë të shumtë në një takim të

mbajtur të dielën në Zvicër. Haradinaj ka thënë se ndihet i nderuar nga mikpritja e ngrohtë. “Faleminderit vëllezër e motra

bashkatdhetarë, më nderuat shumë me mikpritjen e ngrohtë! Jemi bashkë drejt fitoreve për Kosovën!”, ka thënë Haradinaj.



## Rreziku nga dezinformatat, Hoxhaj: Edukimi medial të bëhet pjesë e kurrikulës shkollore

PRISHTINË, 17 MARS - Profesoresha universitare Remzie Shahini-Hoxhaj konsideron se edukimi medial duhet të bëhet pjesë e kurrikulës shkollore në mënyrë që të ngrihet vetëdija

e gjithë shoqërisë për rëndësinë e informatave faktike. Në një intervistë për “The Geopost”, ajo thekson se në këtë mënyrë luftohen dezinformatat dhe Kosova iu

bashkohet shteteve perëndimore të cilat tashmë veç kanë ndërmarrë hapa në këtë drejtim. “Edukimi medial nuk duhet parë vetëm si një lëndë, si një aspekt i të mësuarit në shkolla, por edhe

mediet duhet të krijojnë programe, shkruajnë artikuj sikurse puna juaj, që të informohet publiku çka duhet dhe çka nuk duhet bërë në procesin e informimit”, tha ajo.





## Kryetari i OEK-ut: Bizneset po marrin punëtorë nga Bangladeshi dhe India



PRISHTINË, 17 MARS - Bizneset në vend kanë filluar t'i marrin punëtorë nga jashtë për shkak të mungesës së fuqisë punëtore, ka bërë me dije për "Ekonomia Online", kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna.

Rafuna thotë se bizneset kanë nisur t'i marrin punëtorët nga vendet e largëta si Bangladeshi, India e Nepali, por që po paraqet një siguri që ata punëtorë do të qëndrojnë gjatë në Kosovë.

Rafuna thotë se këta punëtorë që vijnë nga këto shtete po e shohin Kosovën si vend transit për të dalë në vendet më të zhvilluara. "Kjo është një sfidë që është duke përcjell sektorin privat. Tani jemi në vitin e tretë,

sidomos ka qenë e theksuar në dy vitet e fundit, si vite të plota 2022-2023, por as në vitin 2021 nuk përjashtohet. Kjo është një sfidë që e ka përcjellë vendin. Sfida më e madhe për momentin edhe kur bëjmë analizat me anëtarët e Odës Ekonomike shihet mungesa e fuqisë punëtore që paraqitet si sfida më e madhe. Gjithashtu, paraqitet sfidë edhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Përkundër që kanë ndërmarrë masa bizneset për ta zbutur mungesën e fuqisë punëtore ndërmjet investimeve të pajisjeve të teknologjisë ajo po paraqet kosto shtesë për bizneset dhe për importimin e

fuqisë punëtore prej vendeve të tjera, sidomos prej Bangladeshit, Indisë, Nepalit e kështu më radhë. Kjo nuk po paraqet një siguri që ata punëtorë do të qëndrojnë gjatë në Kosovë. Ata po e shohin Kosovën si një vend transit derisa ta gjejnë një mundësi tjetër për të dalë në vendet e Bashkimit Evropian", ka thënë Rafuna, teksa ka përmendur edhe përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e pagës për punëtorë.

Rafuna ka shprehur kritika edhe në drejtim të institucioneve për mungesë veprimi për ndaljen e migrimit. Ai ka thënë se qeveria duhet të hartojë një plan për t'i ndalë të rinjtë që të mos ikin nga Kosova.

## Murati tha se ekonomisë i janë shtuar 2.9 miliardë euro, reagon Bajrami: Kë po provoni ta mashtroni?

PRISHTINË, 17 MARS - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, i ka reaguar ministrit të Financave, Hekuran Murati, pasi tha se ekonomia e vendit ka vazhduar rritjen edhe në tremujorin e katërt gjatë vitit të kaluar, duke dëshmuar qëndrueshmëri të bizneseve tona përballë sfidave të njëpasnjëshme.

Bajrami statistikën e Muratit i ka quajtur mashtrim, duke thënë se ka pasur inflacion enorm mbi 23 për qind. "Hekurani qenka bërë kreativ këtë të diel, por rritja ekonomike sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës duket si në foton e poshtë. Derisa gjatë këtij mandati ka pasur inflacion enorm mbi 23% në kumulativ (2021: 3.4%; 2022: 11.6%; 2023: 5%; shkurt 2024: 2.2%), janë dhënë mbi 240 milionë euro tenderë njëburimor e investimet kapitale të nivelit qendror në 2023 janë sa ato të vitit 2017

vetëm 349 milionë euro. Kënd po provoni ta mashtroni", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Duke e cituar ASK-në, Murati tha se për TM4 2023 rritja reale e ekonomisë ishte 3.96%. Këto shifra anëtarit i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Berat Rukiqi, i ka quajtur manipulim nga ministri Murati. "Ja si manipuloni një i paaftë i pushtetit. Një vit me recesion (rritje negative ekonomike), me aktivitet të përgjysmuar ekonomik, e krahason me një vit me inflacion, me rritje çmimesh, rrjedhimisht me qarkullim të rritur, jo nga rritja reale e aktivitetit ekonomik, por nga rritja e çmimeve në kurriz të qytetareve të vendit", thotë ai. Sipas Rukiqit, mbi tre mijë qytetarë i janë shtuar listës së të varfërve. "Ministër, qytetarët në hall po marrin kredi dhe mbitërheqje në banka, me norma të larta të



interesit, për t'i përballoar shpenzimet. Këta qytetarë që nuk mund ta përballojnë jetën




e shtrenjtë, do të duhej të ishin brenja jote, e jo manipulimi me grafikone. Fatkeqësisht,

për vendin dhe qytetarët, ti je ndër të paafitt e shumtë në këtë qeveri".

## Kosova, e fundit në rajon për pagën mesatare

PRISHTINË, 17 MARS - Kosova është e fundit në rajon sa i përket pagës mesatare.

Një rritje e pagës mesatare në fund të 2023-s me 10 mijë lekë Shqipëria nuk e përmirësoi pozicionin në krahasim me rajonin. 75 mijë lekë ose në monedhën evropiane referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë 723 euro, e renditi përsëri Shqipërinë të parafundit. "Duke pasur edhe një politikë më agresive se vendet e Ballkanit të cilat kanë bërë një rritje sistematike dhe nuk kanë pritur një vit të caktuar për rritjen e madhe pavarësisht se kemi mbrapa Kosovën", thotë Eduart Gjokutaj, ekspert



ekonomie. Kryeson Serbia për pagën mesatare bruto më të lartë në rajon me 1 112 euro, ndjekur më

pas nga Mali i Zi me 1 024 euro, Bosnjë-Hercegovina me 1 023 euro, Maqedonia e Veriut me 975 euro dhe në fund Kosova me 521

euro. "Vendet kampionë nga të cilët duhet marrë modeli që lidhet me produktivitetin e administratës janë Serbia dhe Maqedonia e Veriut të cilat e konkurrojnë me shërbime pavarësisht se nuk kanë nivelin e digitalizimit të shërbimeve publike siç e ka Shqipëria", shtoi Gjokutaj.

Nëse Shqipëria krahasohet me vendin me pagën më të lartë në rajon, ne paguhemi rreth 53% më pak. Por me programin e qeverisë për rritjen e pagës mesatare në 900 euro në mesin e 2024-s, ne do të jemi vetëm 23% larg vendit të parë. "Më duket një përfaqim bazuar mbi një vendim politik sesa një vendim i cili vjen

nga një performancë më e mirë e administratës", tha ai.

Ekspertët e kritikojnë rritjen e pagave pa një program të caktuar ndër vite.

Teksa një kapërcim në 900 euro e konsiderojnë si një mjet politik para zgjedhjeve 2025. "Është pjesë e programit politik të PS-së dhe natyrisht do të deklarohet si një premtim i përmbushur. Duhet këmbëngulur sa ka lidhje me patronazhimin, produktivitetin dhe sa ua vlen shërbimeve të qytetarit", vijoi eksperti.

Për rritjen e pagave në 900 euro qeveria pritet të shpenzojë nga buxheti i shtetit 2024 rreth 40 miliardë lekë./A2 CNN.



# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (3)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

5. Ata e kishin përdorur caq shumë forcën, përfshirë ushtrinë dhe milicinë, me qëllim që t'i tregonin inspiruesve të huaj se çfarë ishte në gjendje të bënte Jugosllavia për të mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e saj. Brenda në Prishtinë ishin përdorur trupa me qëllim që të mbroheshin objektet me të rëndësishme. Të gjitha forcat e rendit kishin udhëzime të repta që të përdornin armë vetëm për vetëmbrojtje.

6. Deri tani, tre anëtarë rezultojnë të vrarë nga milicia, dhe shtatë të tillë nga demonstruesit. Dy nga këta të fundit nuk ishin vrarë nga forcat e rendit por, ata besonin, nga forcat armiqësore që donin gjakderdhje.

7. Autoritetet do të publikonin të gjitha informacionet kur të ishte e vlefshme. Gërllçkov tha se mund të më siguronte që këto ngjarje nuk do të vijonin me shtrëngimin e kontrollit qendror dhe nuk do të lejoheshin që të pengonin procesin gradual të demokratizimit.

Bolland  
Ky telegram nuk është përcjellë.  
[Përcillet sipas kërkesës]

-4-

GR 800  
Fm Beograd 060821Z, prill '81

Prioritet për FCO  
Kopje origjinale  
Nr. tel. 042, datë 6 prill '81  
Informacion për UKDEL NATO  
Kopje për Washington (FCO PSE PASS)  
Telegrami im, nr. 41  
Demonstratat në Kosovë

1. Kryesia Federale dhe Kryesia e Partisë, u mbledhën në një sesion të përbashkët në mbrëmjen e 2 prillit për të diskutuar situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë. Në një deklaratë të publikuar vetëm 24 orë më vonë, ata deklaruan marrëveshjen e tyre me vlerësimet e bëra tashmë nga autoritetet e tjera që ishin mbledhur më parë atë ditë.

2. Sidoqoftë, deklarata kishte disa dallime për sa i përket pikave kryesore. Ajo theksonte se aktivitetet përçarëse të cilat kërcënonin paqen dhe rendin dhe prosperitetin publik ishin organizuar nga elementët irredentistë të cilët kohët e fundit ishin bërë pjesë integrale e rritjes së aksionit të organizuar nga armiku i brendshëm dhe i jashtëm për të shkaktuar destabilizim dhe për të rrezikuar integritetin territorial të Jugosllavisë. Këto aktivitete bazoheshin në konfrontimin e popullit shqiptar me popujt dhe kombet e tjera në Kosovë dhe në Jugosllavi. Aktivitetet kanë filluar me

parulla sociale dhe demagogjike, të cilat kanë mashtruar një numër të caktuar të rinjsh, dhe përfunduan në parulla haptazi armiqësore për irredentizmin shqiptar, duke kërkuar shpërbërjen e Federatës. Autoritetet përgjegjëse patën sukses që të lokalizonin dhe kufizonin trazirat me gjithë grupet e vogla të provokatorëve në radhët e elementëve turbullues të cilët u përpoqën të krijojnë incidente dhe përplasje me agresivitetin e tyre dhe veprimet brutale. Dy kryesitë miratuan masat e marra si të nevojshme dhe të justifikuar për t'i kthyer Kosovës normalitetin.

3. Fadil Hoxha, anëtar shqiptar i Kryesisë Federale dhe Kryesisë së Partisë, shkoi në Prishtinë më 3 prill dhe dha një fjalim para aktivistëve të Partisë, i cili u transmetua në televizion. Ai konfirmoi se ngjarjet e kohëve të fundit kishin ndodhur jo vetëm në Prishtinë, por edhe në pjesë të tjera të Kosovës. Ai i përshkroi ato si kundërrivolucionare. Demonstratat studentore ishin vetëm një pretekst për sulm nga armiqët e Jugosllavisë. Ai e vuri këtë situatë në një kontekst më të gjerë, duke thënë se në një kohë kur situata ndërkombëtare po përkeqësohej dhe ndërhyrja në vendet e tjera po rritej "ishte e qartë se nuk ishte në interesin e disave që Jugosllavia të jetë e qëndrueshme. Përmes trazirave dhe aktiviteteve nacionaliste, ata përipiqen ta bëjnë Kosovën një lidhje të dobët në Jugosllavi dhe të krijojnë kështu një krizë dhe pakënaqësi jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë Jugosllavinë, duke pasur si objektiv shkatërrimin e sistemit politik. Për rrjedhojë, në situatën gjithnjë e më të rrezikshme ndërkombëtare shohim që gishtërinjtë e kundërrivolucionit manipulojnë përsëri në Jugosllavi, Kosovë dhe me gjerë, me qëllim që të krijojnë sërish pasiguri dhe një zonë të re konfliktit për interesa të huaja". Ai shtoi: "ne e dimë se duart e kujt po ndërhyjnë". Më vonë, ai aludoi se kush ishin këta, duke thënë: "Është interesante se nacionalizmi dhe shovinizmi shfaqen në Kosovë aktualisht në frymën e disa koncepteve majtiste dogmatike të cilat nuk ndryshojnë aspak nga parullat armiqësore të periudhës së euforisë informbyroiste. Pavarësisht se çfarë fshihet pas parullave të ndryshme pothuajse marksiste, këto janë veprime të shërbëtorëve dhe agjentëve më të urryer të qendrave dhe agjencive të ndryshme të spiunazhit". Ai bëri të qartë se do të dënoheshin rëndë të gjithë ata që janë përgjegjës për trazirat aktuale dhe çdo përpjekje të mëtejshme.

4. Hoxha vazhdoi të mbronte gjerësisht progresin e arritur nga

Kosova në kuadrin e Federatës dhe zhvillimin e saj nga feudalizmi dhe prapambetja në barazi me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe të përshkruante perspektivën dhe trajtimin e saj të veçantë në Planin e ri 5-vjeçar. Ai përfundoi me një thirrje për vëllazëri dhe bashkim dhe për të gjithë të rinjtë, studentët dhe nxënësit të cilët për çfarëdo arsyeje ishin përfshirë në këtë ngjarje, t'i ktheheshin studimeve dhe punës së tyre. Deklaratat e mëvonshme kanë pranuar se ekzistonte një problem real në ofrimin e punës për studentët që braktisnin shkollat dhe të diplomuarit, problem i cili duhej trajtuar me urgjencë.

5. Që atëherë, media ka nisur një fushatë për të treguar se jeta po i kthehet normalitetit në Prishtinë, megjithëse po e bën këtë duke pranuar se është ende e nevojshme që të studiohen pasojat e këtyre trazirave. Vazhdojnë të vërshojnë mesazhe mbështetjeje nga organizatat socio-politike në të gjithë vendin dhe tashmë nga punëtorët jashtë vendit. Megjithatë, diplomatët dhe gazetarët e huaj nuk janë lejuar që të vizitojnë Krahinën. Dolanc do të japë sot në mesditë një konferencë për shtyp ku do të shpjegojë situatën për gazetarë të huaj.

Bolland  
[Ky telegram nuk është përcjellë]

[Përcillet sipas kërkesës]

-5-

Konfidenciale  
GRS 65A  
Zyra e Informacionit 070700Z  
FMFCO 061900Z  
Direkt për Beograd  
Kopje origjinale  
Nr. tel. 45, datë 6 prill  
Telegrami juaj, nr. 41  
Çështja e Kosovës

1. Jemi mirënjohës për raportimin e plotë të trazirave aktuale. Cig do të konsiderojë hartimin e një dokumenti mbi situatën aktuale të mërkurën në orën 13.00 më 8 prill. Çdo koment i mëvonshëm mund paraqitet nga përfaqësuesi i EESD nëse merret këtu përmes Zyrës së Informacionit, për shembull nga 031200Z.  
Carrington

-6-

GR 1450  
Fm Beograd 071435Z, prill '81

Direkt për FCO

Nr. tel. 044, datë 7 prill  
Informacion për UKDEL NATO  
Kopje për Washington (FCO PSE PASS)  
Telegrami im, nr. 43  
Kosova

1. Në një konferencë për shtyp, më 6 prill, Dolanc bëri përshkrimin më të detajuar gjër më sot mbi ngjarjet e fundit në Kosovë.

2. Ai i vendosi këto ngjarje përballë sfondit të krizës botërore ekonomike dhe zhvillimit të shpejtë të Jugosllavisë që prej luftës për t'u futur në radhët e vendeve mesatarisht të zhvilluara. Duke theksuar se këto influenca nuk mund të ndryshonin politikat aktuale të brendshme dhe të huaja të vetëmenaxhimit dhe mosangazhimit, Dolanc e pranoi se ato shkakton njëfarë opozite në Jugosllavi të stimuluar nga forcat e huaja konservatore dhe reaktionare si dhe disa akte kundërshtimi me

intensitet të ndryshëm në vetë Jugosllavinë. Për sa i përket këtyre të fundit, Dolanc theksoi se këtu nuk bëhej fjalë për një opozitë të organizuar dhe në shkallë të gjerë e cila mund të kishte ndikim të rëndësishëm politik, por për forca të interesuara vetëm për destabilizimin e Jugosllavisë.

3. Ai vuri në dukje se në Kosovë kishte disa grupe nacionaliste që ishin të lidhura me qarqe të caktuara emigrantësh jashtë vendit, të cilat ai i përshkroi ose si profashiste ose si informbyroiste. Ishin bërë përpjekje që këto dy tendenca të shpërnguleshin në Kosovë. Këto grupe emigrantësh ishin të njohura. Ai citoi një të tillë në Shtutgart, një tjetër në Bruksel dhe grupe të tjera në vendet evropiane dhe në SHBA. Këta grupe ishin të mirë organizuara dhe komunikonin me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, tha ai, ishte e mundur që një incident i vogël në një mesë studentësh në Prishtinë, të kthehej në demonstrata që morën domethënie nacionaliste, irredentiste dhe kundërrivolucionare. Demonstratat filluan në Prishtinë dhe përfshinë më së shumti 2,000 njerëz, pjesa më e madhe e të cilëve në grupe që ndryshonin për nga madhësia në kohë të ndryshme. Në radhët e tyre kishte maksimumi 200 elementë të dhunshëm turbullues të cilët ishin përfshirë në thyerjen e makinave, xhamave të dyqaneve dhe i vinin zjarrin forcave të sigurisë. Ata i vinin fëmijët para tyre për të penguar ndërhyrjen e forcave të sigurisë. Demonstratat me flamuj nacionalistë dhe irredentistë u shpërdanë më pas në gjashtë komuna, kryesisht në afërsi të Prishtinës. Demonstratuesit përdornin armë zjarri, kryesisht pistoletë dhe pak pushkë, megjithëse forcat e sigurisë ishin udhëzuar me rreptësi për të përdorur vetëm shkopinj gome dhe gaz lotsjellës. Në disa vende popullsia lokale i shpërndau demonstratat dhe punëtorët refuzuan pranimin e demonstruesve në fabrikat e tyre. Nuk u humb asnjë ditë pune megjithëse disa punëtorë u penguan që të arrijnë në vendet e tyre të punës për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe ndalimqarkullimit. Më 6 prill, këto masa u hoqën ose u pakësuan, veçanërisht u shkurtua periudha e ndalimqarkullimit gjatë natës në mënyrë që jeta ekonomike dhe politike e Kosovës t'i kthehej sa më shpejt normalitetit.

4. Duke iu kthyer fazës tjetër, Dolanc përmendi se mbledhjet e Lidhjes Socialiste po zhvilloheshin në të gjithë Kosovën duke rritur mbështetjen për masat e marra nga udhëheqja e Kosovës, Serbia dhe Jugosllavia. Lidhja e Komunistëve dhe forca të tjera socio-politike do të hidheshin tashmë në ofensivë për të normalizuar situatën me mjete politike. Megjithatë, ai theksoi se nëse do të nevojiteshin masa të tjera, autoritetet nuk do të tërhiqeshin prej tyre dhe pohoi se do të vepronin në mënyrë të ngjashme kundër kujt do që në çfarëdo mënyrë kërcënonin zhvillimin e Jugosllavisë dhe që ishte në kontakt me qarqet reaktionare të krahut të djathtë ose të majtë apo elementët profashistë ose pro informbyroistë dogmatikë jashtë vendit.

5. Duke mbyllur fjalimin e tij, Dolanc shpjegoi vonesën në

informimin mbi situatën në Kosovë me faktin se në fillim autoritetet nuk e kishin vlerësuar se demonstratat do të mermin një intensitet të tillë dhe kishin menduar se nuk ishte e nevojshme për të krijuar ankth. Sipas tij, nuk kishte pasur ndonjë qëllim për t'i mbuluar gjërat.

6. Dolanc zbuloi detaje të tjera kur iu përgjigj pyetjeve. Së pari, ai tha se ushtria kombëtare jugosllave nuk kishte marrë pjesë në trazira, por disa njësi ishin përdorur ekskluzivisht për të siguruar ndërtesa dhe sisteme të veçanta. Nuk ishte plagosur apo vrarë asnjë anëtar i forcave të armatosura. Deri tani kishte pasur 11 viktimë, nga të cilat 9 demonstrues dhe 2 anëtarë të forcave të sigurisë. Viktimat e para rezultuan nga demonstruesit të cilët hapën zjarr në njerëz. Forcat e sigurisë kishin hapur zjarr dy herë kur ishin gjendur përballë zjarrit në Vushtri dhe Ferizaj. Në këto raste dy demonstrues ishin vrarë, por pjesa tjetër e personave të vdekur ishin gjetur në rrugë dhe për këtë u hap një hetim për të zbuluar shkakun e vdekjes së tyre. Një anëtar i forcave të sigurisë ishte qëlluar dhe tjetri ishte vrarë me gurë.

7. Dolanc tha se aktualisht nuk mund të thoshte që pas këtyre ngjarjeve ishte qeveria shqiptare dhe se shpresonte që Shqipëria do të vazhdonte të ndiqte politiken e Enver Hoxhës në interes të pavarësisë, integritetit dhe qëndrueshmërisë së kufijve të Jugosllavisë. Ai nuk shihte ndonjë rrezik që mund të largonte popullsinë e Kosovës nga Jugosllavia nëse lejohej lulëzimi i lidhjeve kulturore me Shqipërinë. Tekstet shkollore importoheshin nga Shqipëria dhe 11 mesues shqiptarë jepnin mësim në Prishtinë. Lidhje të tilla kulturore me Shqipërinë duhej të vazhdonin. Ai konfirmoi se një prej parullave kryesore në demonstrata kishte qenë "Kosova Republikë". Ai pohoi se ishte e pamundur dhe antikushetuese që të krijohej Republika e Pavarur e Kosovës dhe kjo nënkuptonte shpërbërjen e Jugosllavisë. Ai e minimizoi armiqësinë midis serbëve dhe shqiptarëve, duke pohuar se tani kishte 30,000 serbë më shumë në Kosovë sesa pas eksodit në vitin 1966.

8. Bakalli, Kryetar i Komitetit Qendror të Kosovës, pranoi haptazi përmes një deklaratë në mbledhjen e Partisë më 6 prill, vlerësimin e gabuar të autoriteteve mbi demonstratat e para. Ato ishin përqendruar në kapërcimin e problemeve të jetesës së studentëve dhe nuk ishin marrë sa duhet me zbulimin e karakterit armiqësor të organizatorëve të demonstratave. Ai akuzoi se Komiteti Qendror i Kosovës duhej që në mbledhjen e radhë të analizonte dhe vlerësonte këto ngjarje, shkaqet e tyre dhe rrethanat në të cilat këto veprime armiqësore arritën të gjenin hapësirë për t'u shprehur përmes demonstratave. Sidoqoftë, ai tha se ishte e nevojshme të pohohej tani se Lidhja Komuniste në Kosovë kishte dështuar për të trajtuar situatën politike me efikasitet.

9. Media aktualisht shpreh se jeta duket se po i kthehet normalitetit në Prishtinë. Por, gazetarët e huaj nuk do të lejohen të hyjnë të paktën deri në fundjavë. Diplomatët janë ende të përjashtuar nga ky rregull.

Bolland  
[Përsëritet sipas kërkesës]



# Princesha dhe Photoshop-i



## Molly ROBERTS

Ku është Kate? Cështja është kthyer kohët e fundit në një teori konspiracioni, e përqëndruar tek “Zhdrukja” e Katerinës, Princesës së Uellsit, pas atij që Kensington Palace e ka quajtur një operacion në abdominale. Fundjavën e kaluar, bota e mori një përgjigje: Ja tek është, duke buzëqeshur me tre fëmijët – vetëm se, prit pak, diçka e çuditshme po ndodhte me duart e tyre.

Një foto e familjes së lumtur të Princit Harry, e nxjerrë nga pallati me sa duket për të qetësuar spekulesit, përfundoi duke bërë ekzaktësisht të kundërtën kur u zbërthyen njëra pas tjetres çuditë e fotografisë.

Incidenti përmban shumë mësimë mbi mënyrën se si epoka e inteligjencës artificiale, na ka bërë të mos besojmë atë që shohim. Fotografia, duhet pranuar, është e gjitha gabim. Shikoni unazën e munguar të martesës së Kate. Shikoni gishtërinjtë e Princit Louis. Shikoni mëngën e shtrembëruar të Princesës Sharlotë. Ata që merren me teoritë e konspiracionit, që kanë filluar të flasin për gjithçka, nga kirurgjia plastike deri tek divorci apo vdekja, krejt papritur patën shumë material ditën e diel për teoritë e tyre. A ishte shtuar fytyra e princesës së humbur pas faktit, ndoshta e marrë nga ndonjë kopertinë e vjetër e revistës Vogue? A ishte një fotografi e vjetër, e ringjyrosur dhe e pajisur me një sfond të ri, për t’ua hedhur shikuesve? Dhe a ishte e gjitha e realizuar me inteligjencë artificiale – në gjendje, këto kohë, që të sjellë në

jetë gjithfarëloj skenash të imagjinuara, shumë prej tyre të mbushura me shtojca të dyshimta anatomikisht?

Associated Press, pasi e shpërndau fillimisht fotografinë, nxorri një njoftim për ta fshirë atë tek të gjitha mediat – duke paralajmëruar gazetarët se një “inspektim më i afërt tregon se burimi e ka manipuluar fotografinë”. Vetë burimi e ofroi shpjegimin pasi kaloi një ditë. “Ashtu si shumë fotografë amatorë”, princesha shkruajti në një deklaratë, “edhe unë eksperimentoj shpesh me përpunimin e fotove”. Ah po, kush prej nesh nuk i shton një palë dhëmbë vogëlushëve tanë, përpara se t’i nxjerrim në Instagram?

E vërteta është ndoshta jo aq e pafajshme sa thanë mbretërorët, as edhe aq e keqe sa pretendon publiku. Ndoshta vetë Catherine nuk i kalon ditët e saj duke përpunuar imazhe në Photoshop, siç sugjeron ajo, por duket se në këtë rast dikush e ka bërë: BBC raporton se analiza e të dhënave të fotografisë tregon se fotoja është bërë me një kamera digjitale, më pas është ruajtur dy herë me një program. Artistët që merren me ndryshimin e fotografive e kanë përdorur mjetin për të fshehur puçrrat nga fytyrat e mbrëmjes së maturës, që dhjetë vjet më parë. Por këto kohë, Photoshop ka edhe të tjera aftësi.

Ndonëse Inteligjenca Artificiale mund të përpunojë diçka që nuk

ka ekzistuar kurrë, ajo gjithashtu mund ta ndryshojë realitetin fët e fët, dhe produkti nuk është as totalisht real dhe as totalisht i rremë. Zbut lëkurën; shto disa tipare tërheqëse; hiq atë tipin me kapele të shëmtuar.

“Perfeksionoi kujtimet e tua”, premton Edituesi Magjik i Google. Kjo është tunduese.

Ti mund të përdorësh një mjet të thjeshtë në Smart Portrait të Photoshop, për t’i bërë të gjithë që të shohin nga aparati fotografik. Më mirë akoma, mund t’i bësh ata të duken më të rinj apo më të moshuar. Më e mira nga të gjitha, mund t’i bësh të duken më të lumtur. Imagjinoni tani Princeshën që e çon gradën në maksimum. Nën atë lloj presioni, do e bëje edhe ti.

Njerëzit mund të mos e kuptojnë gjithmonë që po mbështeten tek Inteligjenca Artificiale për të bërë këto marifete; në fund të fundit, ndihesh thjesht sikur je duke klikuar një buton. Por bashkë me të vijnë edhe shenjat tipike të manipulimit, si duart e dryshuara apo teksti i pakuptueshëm.

Telashi që këto mjete të Inteligjencës Artificiale i sjellin shoqërisë është i ngjashëm me problemin e të ashtuquajturve lajme të rreme. Progresistët e përdorin për të përshkruar dezinformatat e huaja ndërsa konservatorët e përdorin për të diskredituar raportimet e sakta, kur nuk u volisin. Ne që tani po zhvillojmë një refleks për të vënë në dyshim çdo fotografi apo video që shohim online, sepse kështu duhet. Por kjo bën që, jo vetëm të jetë më e lehtë të krijosh imazhe të rreme në epokën e Inteligjencës Artificiale; është gjithashtu më e lehtë të pretendosh që imazhet janë të rreme, edhe kur nuk janë.

Këto ndryshime u vijnë si ushqim përhapësve të teorieve konspirative, të cilëve u pëlqejnë të vënë theksin tek koincidenat, mungesën e qëndrueshmërisë dhe falsiteteve që shfaqen në jetën e përditshme, si prova të kompleteve të errëta.

Princesha Catherine editoi një fotografi, ndoshta pak, ndoshta shumë, dhe me sa duket kjo është provë që herën tjetër që do ta shohim, do të jemi duke parë një sozi. E vetmja zgjidhje do të ishte që çdokush të vëhej i vërtetë – sidomos njerëzit e famshëm dhe të pushtetshëm, dhe sidomos princeshat. Fatkeqësisht, ata janë më pak të prirur që ta bëjnë këtë. / The Washington Post – Bota.al





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Dy derbit përfundojnë pa fitues

Dy derbit e javës në elitën e futbollit të Kosovës, Drita-Gjilani dhe Ballkani-Llapi kanë përfunduar pa fitues. Gara për titull vazhdon të jetë interesante, sikurse gara për mbijetesë dhe për të dalë në Evropë

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 17 MARS** - Derbi i skuadrave nga Anamorava, Drita dhe Gjilani ka përfunduar baras 2-2, në një përplasje emocionuese në xhiron e 26-të të Superligës së Kosovës në futboll. Ky barazim nuk i ka shkuar shumë përshtati skuadrës së Dritës, e cila lëshoi rastin që t'i afrohet Ballkanit dhe Llapit dhe në këtë mënyrë vazhdon të jetë në pozitën e tretë me 50 pikë. Gjilani, nga ana tjetër, fitoi pikë të rëndësishme në garën

për të shpëtuar nga rënia në Ligën e Parë dhe tash është në vendin e shtatë me 26 pikë. Blendi Baftiu shënoi për Dritën në minutën e 24-t, Gjilani e përmbysi këtë epërsi të Dritës me dy gola të shënuara nga Edi Basha (32) dhe Qëndrim Ismajli (44). Mirëpo, në minutën e 55-të, e barazoi rezultatin me golin e Albert Dabiqaj. Në ndeshjen mes Fushë Kosovës dhe Prishtinës nuk pati fitues e as gola të shënuara duke përfunduar ndeshja me rezultat 0-0. Ndërkaq, Dukagjini triumfoi në përballje me Feronikelin 74 (1-0), me një



gol të Altin Merlakut, në minutën e 45-të. Të shtunën derbi ndërmjet Ballkanit dhe Llapit përfundoi pa fitues (0-0). Ndeshja e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Suharekë u karakterizua nga pritjet vendimtare të portierëve Enea Koliçi dhe Ilir Avdyli, si dhe nga ndërhyrja e rëndësishme e

qendërmbrojtësit Ilir Krasniqi, krejt në fund të ndeshjes që e shpëtoi Llapin nga pësimi i golit. Ballkani vazhdon të udhëheqë me 52 pikë, një më shumë se Llapi, që ndodhet në vendin e dytë. Ndërkohë, Malisheva tregoi formën e saj të shkëlqyeshme duke shënuar një fitore të thellë 3-

### SUPERLIGA - Java 26

Drita - Gjilani	2-2
Fushw Kosova - Prishtina	0-0
Dukagjini - Feronikeli 74	1-0
Liria - Malisheva	0-3
Ballkani - Llapi	0-0

#### Tabela

		Pikë
1. Ballkani	26	52
2. Llapi	26	51
3. Drita	26	50
4. Malisheva	26	47
5. Prishtina	26	38
6. Dukagjini	26	34
7. Gjilani	26	26
8. Feronikeli 74	26	26
9. Fushë Kosova	26	20
10. Liria	26	10

0 kundër Lirisë në stadiumin "Përparim Thaçi". Drilon Hazrollaj, Etnik Brruti dhe Agon Xhaka ishin shënues për Malishevën.

## Bashkimi fiton derbin prizrenas, Prishtina me fitores bindëse ndaj Istogut

**PRIZREN, 17 MARS** - Bashkimi ka fituar derbin prizrenas dhe ka shënuar një fitore shumë të rëndësishme për "play-off", duke mundur Proton Cable Prizrenin me rezultat 90:101 (19:20, 21:28, 26:29, 24:24), në javën e 25-të të Prince Caffë Superligës. Bashkimi e nisi ndeshjen më mirë me një seri prej 5:14, por vendasit u rikthyen shpejt dhe afruan shifrat në 19:20, sa përfundoi çereku i parë, derisa lojë e barabartë u



zhvillua edhe në periudhën e dytë, deri në fund, kur Portokallejnjtë me tetë pikë radhazi, shkuan në pushim 40:48. Bashkimi ngriti

epërsinë deri në 14 pikë, 55:69, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 66:77. Proton Cable Prizreni afro shifrat në 90:95, por nuk arriti më shumë dhe Bashkimi triumfoi 90:101.

Ty Cockfield me 27 pikë, pesë kërcime e katër asistime u dallua te vendasit, derisa Lejson Zeqiri me 26 pikë, tetë kërcime e katër asistime te mysafirët ishte më i miri.

Proton Cable Prizreni mbetet në

vendin e shtatë me shtatë fitore e 18 humbje, kurse Bashkimi i gjashti me dhjetë fitore e 15 humbje. Ndërsa Sigal Prishtina shënoi fitore bindëse dhe të pritur ndaj Istogut me rezultat 125:71 (37:16, 25:22, 28:17, 35:16). Bardhekaltrit dominuan nga fillimi deri në fund, ku kjo sfidë nuk kishte shumë histori, me prishtinasit që u rikthyen te fitorja në elitë, derisa istogasit me basketbollistë vetëm vendorë që po luajnë mbetën në

vendin e fundit. Te prishtinasit u dalluan Visar Ejupi me 40 pikë e katër kërcime, Donovan Smith me 31 pikë e 17 kërcime dhe Donte Clark me 21 pikë, 13 kërcime e 11 asistime, kurse te mysafirët u dalluan Arian Azemi me 27 pikë, gjashtë kërcime e shtatë asistime dhe Orges Shatri me 22 pikë e 11 kërcime. Sigal Prishtina është e katërta me 15 fitore e dhjetë humbje dhe Istogu në vendin e fundit me një fitore e 24 humbje.

## Presidenti i Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar nis vizitën e tij në Kosovë

**PRISHTINË, 17 MARS** - Presidenti i Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar, Andrew Parsons, po qëndron në vizitë në Kosovë. Ai së bashku me kreun e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Njomza Emini sot kanë bërë hapjen e garave të boçës, goalballit dhe xhudos në palestren e Pallatit të Rinisë në Prishtinë. Emini shprehu mirënjohje për prezencën e Parsons në Kosovë, duke thënë se vizita e tij është dëshmi e përkrahjes nga një institucion gjigand i paralimpizmit botëror. "Ne, të bashkuar, do të vijojmë

rugëtimin tonë në "Paris 2024", duke shënuar kështu kalimin e kufijve dhe duke garuar me para sportistë të klasës botërore", ka thënë Emini. Ndërsa, Parsons ka thënë se pranimi i Komitetit Paralimpik të Kosovës ndërkombëtarisht është bërë falë përpjekjeve të kreut të saj Njomza Emini, e cila u përkushtua jo vetëm për këtë proces dhe pjesëmarrjen në lojëra ndërkombëtare, por edhe për fuqinë e këtij komiteti si forcë ndryshimi në Kosovë. Parsons gjatë ditës ka vizituar Komitetin Paralimpik të Kosovës, ku takoi



Bordin Drejtues të këtij komiteti, me të cilët diskutoi rreth zhvillimit të paralimpizmit në vendin tonë, sfidat dhe rrugën përpara, duke premtuar mbështetje në realizim të objektivave të tyre. Ndryshe, Parsons do të zhvillojë takime edhe me përfaqësues dhe krerë institucionesh, personalitete të sportit dhe partnerë të para sportit. Kjo është vizita e parë e tij, e cila organizohet nga Komiteti Paralimpik i Kosovës, pak muaj pas anëtarësimit të vendit tonë në këtë instancë ndërkombëtare.

## Kurti takon Rrahmanin: I urova suksese në fanellën e Kosovës

**PRISHTINË, 17 MARS** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka prituri në takim futbollistin Albion Rrahmani. Kurti ka thënë se Rrahmani u bë sulmues i preferuar i Superligës rumune.

"Me talentin e trashëguar nga familja dhe me punën e tij të pandalshme, Albioni në Superligën rumune sivjet ka shënuar 14 gola në vetëm 16 ndeshje të zhvilluara, duke ecur

me hapa të sigurt për t'u bërë golashënuesi më i mirë i kampionatit", ka deklaruar Kurti. I pari i qeverisë i dëshiroj futbollistit, shumë suksese tutje, në veçanti në ndeshjet që do t'i

zhvillojë me fanellën e Kosovës. Sulmuesi i Rapidit të Bukureshtit do të jetë pjesë e kombëtares së Kosovës në dy ndeshjet që do t'i luajë në mars kundër Armenisë dhe Hungarisë.





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

